



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 26 maj 2009

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Mbledhja filloi në orën 13:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Melihate Termkolli, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Gani Geci dhe Ibrahim Selmanaj.

Munguan: Bojan Stojanović, Agim Veliu, Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të **06. 05. 2009** dhe të **12. 05. 2009**,
3. Shqyrtimi i Raportit në lidhje me rastin në Policinë e Kosovës të **25. 04. 2009**,
4. Shqyrtimi i Raportit të progresit të Komisionit Evropian, të dërguar nga MPB,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 06. 05. 2009 dhe të 12. 05. 2009

Procesverbalet e 06. 05. 2009 dhe të 12. 05. 2009 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit në lidhje me rastin në Policinë e Kosovës të 25. 04. 2009

Kryetari i Komisionit – Tha se nga Komisioni e keni marrë Raportin me rekomandime lidhur me incidentin që ka ndodhur në Policinë e Kosovës. Në fund janë dhënë disa rekomandime. Propozoi të lexohen këto rekomandime dhe të miratohet Raporti me kërkesë që t'i dërgohet seancës plenare për shqyrtim.

Emrush Xhemajli – Theksoi se pajtohet me rekomandimet e Komisionit. Kishte disa vërejtje për pikën e dytë, në të cilën duhet të saktësohet se ato ishin shumë të përgjithësuara. Te pika 2, thuhet se drejtori i Policisë duhet të shkarkohet. Këtu duhet të theksohet titulli zyrtar që e ka emëruar. Duhet të thuhet se për shkak se nuk ka prova konkrete, nuk kanë marrë masa për sanimin e gjendjes në objektin ku gjendet Dhoma e Provave, me gjithë rekomandimet e mëhershme të Inspektoratit të Policisë. Të ceket (shih raportin e Inspektoratit 2008), se krijimi i Task Forcës i ka penguar hetimet e mirëfillta, sepse nuk e ka pezulluar veten të ketë mundësi të hetohet.

Melihate Tërmkollli – Tha se e shoh një përpjekje për të marrë masa për shkarkimin e drejtorit të Policisë. Mendon se në këto rekomandime mungon çështja e përgjegjësisë së Ministrisë dhe e Qeverisë. Ministri i MPB-së asnjëherë nuk ka bërë deklaratë serioze për rastin që ka ndodhur. Mendon se këtu mungon rekomandimi për institucionin më përgjegjës, për ministrin dhe Qeverinë.

Kryetari i Komisionit – Shtoi se vetëm deshi të sqarojë që rekomandimet t'i adresohen Qeverisë. Dy rekomandimet e para tashmë janë votuar dhe sot votohet për rekomandime të tjera.

Gani Geci – Tha se pajtohet me znj. Termkolli për disa parime bazë. Ne do të kërkojmë përgjegjësi aty ku na takon si Komision mbikëqyrës parlamentar në bazë të ligjeve dhe të Rregullores së punës të Kuvendit.

Melihate Termkolli – Theksoi se vetëm deshi të pyeste: pse deri tani nuk është shtruar për diskutim çështja e sigurisë në Kuvendin e Kosovës. Komisioni ka kërkuar para disa javësh që kjo çështje të debatohet. Nga kjo përgjigje varet edhe çështja e këtyre rekomandimeve.

Ibrahim Selmanaj – Tha se kanë kaluar 30 ditë që kur ka ndodhur rasti në Policinë e Kosovës dhe ende nuk kemi asnjë përgjigje. Nuk kemi linjë të qartë se deri ku kanë shkuar hetimet dhe kush është përgjegjës. Një e vërtetë tjetër e pakontestueshme është se tani edhe shkarkimi i drejtorit të Policisë është i pakuptimtë.

Shkumbin Demaliaj – Shtoi se duhet ta ndjekim rrugën institucionale. Këto rekomandime duhet të dërgohen në Kryesi të Kuvendit dhe kjo çështje të debatohet në Kuvend.

Eqrem Kryeziu – Vuri në pah se nga këto propozime do ta zgjidhte solucionin e krijimit të një komisioni hetimor. Mendon se nuk duhet të nxitohet, sepse ka procedura dhe do të bëhet gjithçka të zbardhet rasti që ka ndodhur.

Shkumbin Demaliaj – Theksoi se në mbledhjen e kaluar ministri deklaroi se janë duke punuar grupet hetimore për zbardhjen e rastit, që t'i kthehet dinjiteti Policisë së Kosovës. Mekanizmat e sigurisë dhe ata të Qeverisë, në pikëpamje morale, nuk kanë treguar gatishmëri që neve, si Komision funksional, të na tregojnë për kohën kur ndodhi rasti. Bëri thirrje t'i ndjekin procedurat dhe që kjo çështje t'i dërgohet Kryesisë së Kuvendit, që të shqyrtohet nga deputetët.

Gani Geci – Shtoi se në Kuvend kanë të drejtë të kërkojnë të formohet një komision hetimor, por Kryesia e Kuvendit nuk mund të sillt papërgjegjshëm me situatën e sigurisë në Kosovë. Ne po kërkojmë zbatimin e ligjeve që janë nxjerrë me bashkësinë ndërkombëtare. Kemi konstatuar se krijimi i Task Forcës është joligjor dhe nëse lejojmë të formohet diçka joligjore, duhet të jemi përgjegjës.

Kryetari i Komisionit – Tha se nga Ministria është konstatuar që nuk është joligjore, mirëpo ne e kemi cilësuar të panevojshme. A pajtoheni me këto rekomandime?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me rekomandimet.

Kryetari i Komisionit – Theksoi se janë dy mënyra për të shkuar në seancë. Nuk kisha dashtë që të krijohet komisioni hetimor derisa të kryhen hetimet. A pajtoheni që të ftojme në seancë ministrin, Zenun Pajaziti?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin.

4. Shqyrtimi i Raportit të progresit të Komisionit Evropian, të dërguar nga MPB

Kryetari i Komisionit – Tha se dje ka qenë në një konferencë me kryetarët e komisioneve parlamentare dhe është marrë vendim që të përshpejtohet puna për përmbushjen dhe raportimin për këto detyra. Ne, si komision, kemi një raport të dërguar nga MPB, që tashmë e keni. Tremujori i parë është kryer sa u përket pikave të parapara në Komision.

Anëtarët e Komisionit miratuan raportin e progresit të Komisionit Evropian.

Emrush Xhemajli – Theksoi se do të ishte mirë që për fushat, për të cilat po flasim, t'i ftonim për t'i dëgjuar. Bëhet fjalë për mbikëqyrjen e integruar të kufirit. Është shumë e nevojshme ta kemi njeriun përgjegjës që të dimë diçka dhe të mos kemi vetëm teori.

5. Të ndryshme

Meqenëse nuk kishte pika të tjera për shqyrtim, kryetari i Komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

.....
Rrustem Mustafa